



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:270277  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05629709

KPPP.nr.2087/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “ORBICO” Sh.P.K., me adresë Magjistralja Prishtinë-Shkup, Llapnaselo, Prishtinë, me NRB: 70213697, kundër debitorit “Vocolli” Sh.P.K., me adresë në Brecë, Podujevë, me NUI: 810439548, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1767/23 të datës 17.10.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës me datë 24.04.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

1. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “Vocolli” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.1767/23 të datës 17.10.2023, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, dhe i njejt Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrin Përmbartimor P.nr.1767/23 të datës 17.10.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.FSHP21-09950 të datës 06.09.2021, me të cilin ka urdhëruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimeve nga fatura më sipër, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 4,044.79 Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore (lartësinë e së cilës BQK e publikon në bazë të rregullt gjashtëmujore

sipas Ligjit nr.05/L-110 për Kamatëvonesa në Transaksione Tregtare) duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përbaruesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim me arsyetimin se urdhri ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës përbarimore si dhe konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për faktin se lidhur me kamatën e kërkuar palët nuk kanë asnjë marrëveshje apo kontratë e cila specifikon se në rast vonesash aplikohet kamatëvonesa. Më tej ka theksuar se kreditori lëshimin e faturave nuk e ka bazuar në një kontratë apo marrëveshje mes kreditorit dhe debitorit lidhur me furnizimet e specifikuar në fatura. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet në tërësi si i bazuar ndërsa urdhri përbarimor i Përbaruesit Privat të anulohet në tërësi.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se përbarimi është lejuar duke u bazuar në dokumentin e besueshëm të evidentuar si në urdhrin për përbarim i cili paraqet titull ekzekutiv, pasi i njëjti posedon të gjitha elementet e përcaktuara si në nenin 29 pika 3 të LPP-së. Më tej ka theksuar se debitori në prapësim nuk ka provuar e madje nuk ka bashkëngjitur asnjë fakt të paraparë në nenin 71 të LPP-së. Ka shtuar se dokumentin e besueshëm kreditori ia ka dorëzuar debitorit në mënyrë të rregullt dhe është nënshkruar nga zyrtarët, mbi këtë bazë Përbaruesi ka lejuar përbarimin ndaj debitorit. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pathemeltë, ndërsa urdhri P.nr.1767/23 i datës 17.10.2023 të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit

1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm/faturën nr.FSHP21-09950 të datës 06.09.2021, me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura e lartcekur përmban të gjitha elementet të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37 për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e njejta është dorëzuar në kopje të vërtetuar sipas ligjit dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt i cili vërtetohet me vulën dhe nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Në kuptim të nenit 73 të LPP-së, gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2087/23, me datë 24.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.